



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ

Nr. _____ prot.

Kamëz, më 17 / 01 / 2025

Lënda: Kthim-përgjigje

Drejtuar: Redaksia e gazetës komunitare “Nyje.al”

Adresa postare: Bulevardi “Blu”, përballë stacionit të shkollës “Ibrahim Rugova”, Kamez

Të nderuar

Në përgjigje të kërkesës për informacion, na lejoni t’iu informojmë si më poshtë vijon:

1. Sa është numri i anëtarëve të pakicës rome dhe sa është numri i anëtarëve të pakicës egjyptiane që banojnë në bashkinë Kamëz?

Sipas studimit të bërë nga Drejtoria e Ndhmës Ekonomike dhe Çështjeve Sociale të Bashkisë Kamëz janë regjistruar 329 familje rome dhe Egjiptjane me 1333 anëtarë.

2. Sa është numri i të pastrehëve në Bashkinë Kamëz? Sa është numri i qytetarëve të pastrehë nga pakica Rome dhe nga pakica Egjyptiane që kanë aplikuar për strehim social pranë bashkisë Kamëz?

Në Bashkinë Kamëz kanë aplikuar 324 familje referuar programeve të strehimit social, të cilit 17 prej tyre janë pjesë e pakicës Rome dhe Egjiptiane.

3. Sa është numri i qytetarëve që përfitojnë ndihmë ekonomike në bashkinë Kamëz? Sa është numri i qytetarëve nga pakica rome dhe nga pakica egjyptiane që kanë aplikuar për ndihmë ekonomike dhe sa është numri i përfituesve?

- Familjet Egjiptiane që trajtrohen me ndihmë ekonomike nga Sistemi Elektronik i Ndhmës Ekonomike janë 39 familje me 175 anëtarë , ndërsa pakicat Rome janë 7 familje me 36 anëtarë.
- Familjet Egjiptiane që trajtrohen me ndihmë ekonomike nga Fondi 6% I Bllok- Ndhmës Ekonomike janë 5 familje me 6 anëtarë ndërsa pakicat Rome nuk trajtohen aktualisht.
- Familjet Egjiptiane që trajtrohen me ndihmë ekonomike nga Fondi i Buxhetit të Bashkisë Kamëz janë 6 familje me 30 anëtarë ndërsa pakicat Rome 1 familje me 4 anëtarë.

4. Sa është numri i individëve pa punë që kanë aplikuar si punëkërkues nga pakica rome dhe nga pakica egjiptiane në bashkinë Kamëz?

- Punëkërkues nga komuniteti rom dhe egjiptianë janë paraqitur pranë zyrës së punës 112 persona.

3. Sa është numri i të punësuarve në sektorin e pastrimit të bashkisë Kamëz? Sa është numri i të punësuarve nga pakica rome dhe nga pakica egjiptiane në sektorin e pastrimit pranë bashkisë Kamëz?

Pranë Ndërmarrjes së Pastrimit Kamëz, numri i të punësuarve është 175 punonjës, ku nga këto komunitetit rom i përkasin 45 punonjës.

Ju faleminderit!